

## Njoftim

**Mbi ndryshimin e vendimit nr.25 datë 12.07.2007 “Mbi caktimin e normave të interesit për pagesat e vonuara” të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, me anë të Vendimit nr.30 datë 06.10.2010 të Këshillit Drejtues të APD**

**Drejtoria Ekzekutive e Autoritetit Portual Durrës, njofton aplikimin e normave të interesit për Operatorët dhe Përdoruesit Portualë si më poshtë vijon:**

**1. Normat e interesit për pagesat e vonuara janë:**

- Për pagesat që kryhen brenda 20 ditëve nga data e prerjes së faturës, nuk aplikohet normë interesi.(ajo do të jetë 0)
- Për pagesat që kryhen nga 21 ditë deri në 90 ditë nga dita e prerjes së faturës, norma e interesit do të jetë 20%/365 për çdo ditë vonese.

**2. Operatorët e autorizuar dhe përdoruesit e portit për të cilët,**

I) nuk kanë kryer pagesën brenda 90 ditëve nga data e prerjes së faturës, i ndalohet përdorimi i portit deri në likuizdimin e plotë të detyrimit.

Dhe/ose

II) kur vlera e faturimeve të marra së bashku, kalon limitin 30 000 000 lekë,

Cilido nga kushtet plotësohet më parë, i ndalohet përdorimi i portit deri në likuizdimin e plotë të detyrimit

**2.2** Ndalimi i Përdorimit të portit deri në likuizdimin e plotë të detyrimit sipas pikës 2.1, merret ndaj subjekteve debitore, ndaj Operatorëve të ngarkim shkarkimit për detyrime apo marrëdhënie kontraktuale që rrjedhin nga Kontrata Liçensë.

Kjo masë nuk shkarkon kompanitë e ngarkim shkarkimit nga detyrimet e tyre kundrejt APD- së të rrjedhura nga kontrata liçensë.

**3. Ky vendim do të aplikohet për detyrimet e lindura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi më 24 Dhjetor 2010.**

Për informacione të mëtejshme, Ju lutemi të kontaktoni në Drejtorinë Ekzekutive të Autoritetit Portual, Nr tel/ fax 052 223115 dhe faqen e internetit [www.apdurrës.com.al](http://www.apdurrës.com.al).